



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

## **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**PËR  
ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME  
TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2021**



Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

*Tiranë, Prill 2022*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE**  
**TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË**  
**TË VITIT 2021, TË USHTRUAR NË AUTORITETIN SHTETËROR TË INFORMACIONIT**  
**GJEOHAPËSINOR (ASIG)**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**PËR**  
**ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E**  
**MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT**  
**2021**

**Titulli:** Për kryerjen e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Autoritetin Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor (ASIG)

**Subjekti:** Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor (ASIG)

**Përgatitur:** Mars 2022

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 227 prot, datë 22.02.2022.

Auditimi është kryer nga:

1. Benard Haka, *përgjegjës grupi*
2. Meald Habazaj, *anëtar*

## PËRMBAJTJA

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>3</b>
<b>II.</b>	<b>Hyrje</b>	<b>3</b>
	1. Objekti i auditimit	4
	2. Qëllimi i auditimit	4
	3. Metodologjia e auditimit	4
	4. Konkluzione	4
	5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
<b>III.</b>	<b>Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm</b>	<b>5</b>
	1. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtiveve të auditimit	5
	2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes	5
	3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njohimit të raportit të auditimit	5
	4. Realizimi i rekomandimeve	6-17
<b>IV.</b>	<b>Konkluzione dhe Rekomandime</b>	<b>18-21</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Autoritetin Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor (ASIG) (këtu e në vazhdim ASIG) : *“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2021”*, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisione disiplinore për dhënien e masave disiplinore.

### ***Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit rekomandimeve:***

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC
- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 *“Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Udhëzimi i Kryetarit të KLSH-së, nr.1, datë 04.11.2016 *“Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”*
- Rregullore e Brendshme *“Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së”*, nr.85, datë 30.06.2015;
- Rregullore *“Mbi procedurat e auditimit në KLSH”*, miratuar me vendimin nr.107, datë 08.08.20017 të Kryetarit të KLSH-së.

## II. HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”*, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 *“Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, Programit të Auditimit nr. 227 prot., datë 22.02.2022 me objekt: *“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2021”*, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për marrjen e masave organizative, dhe të masave për shpërblim dëmi, e të tjera, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH-ja për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë subjekt, ku rezultoi se:

-Në përfundim të Auditimit është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, me shkresën nr. 47/9, datë 06.08.2021, për auditimin e ushtruar.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, ASIG, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, ku ka dërguar planin e veprimeve, duke përcaktuar rekomandimin e KLSH-së, personat përgjegjës, reagimin e menaxhimit dhe afatet e përcaktuara.

-Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja me njoftim për hartimin e programit të punës dhe realizimit të plan veprimit dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH-ja, duke respektuar afatin 6 mujor, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

Auditimi është kryer nga:

1. Benard Haka, (*përgjegjës grupi*)
2. Meald Habazaj, (*anëtar*).

**- Çështjet e Audituaras:**

1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (germa “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”). Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (*pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014*).

2. Realizimi i rekomandimeve për *ndryshime apo përmirësime në legjislacionin* në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

**II.1. Objekti i auditimit**

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

**II.2. Qëllimi i auditimit**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**II.3. Metodologjia e auditimit**

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “*Udhëzime mbi rregullat e auditimit*”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “*Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve*”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

**II.4. Konkluzione**

Në përfundim të procesit të punës audituese në terren nga subjekti i audituar nuk u paraqiten kundërshti mbi Akt Verifikimin e mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-

ja.

Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 15 masa. Janë zbatuar 8 masa, janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative. Nga masat për shpërblim dëmi është pranuar dhe zbatuar plotësisht 1 masë.

### **II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve**

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i realizimit të rekomandimeve është mbi 56 %, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatimi ose janë zbatuar pjesërisht duhet akoma më shumë punë për realizimin në nivelin 100% të rekomandimeve.

### **III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2019-31.12.2020**

Auditimi ka filluar më datë 23.02.2022

Auditimi ka përfunduar më datë 11.03.2022

#### **III.1.Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit**

Nga ana e KLSH, me shkresën nr. 47/9 prot, datë 06.08.2021 për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 15 masa organizative dhe një masë për shpërblim dëmi. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 15 masa. Janë zbatuar 8 masa, janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative. Nga masat për shpërblim dëmi janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 1 masë.

#### **III.2.Hartimi i programit (Plan veprimi) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**

ASIG në përgjigje të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të dërguar me shkresën tuaj nr. 47/9 prot., datë 06.08.2021 e protokolluar në ASIG me nr. 198/1 Prot., datë 09.08.2021, ASIG ka marrë masat për ndjekjen dhe zbatimin e tij si më poshtë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 64, datë 09.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASIG, janë miratuar:

- Programi i punës për realizimin e rekomandimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, miratuar me shkresën nr. 198/3 prot, datë 27.08.2021;
- Relacion mbi masat e marra për zbatimin e Programit të Punës për rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit, miratuar me shkresën nr. 198/4 prot, datë 27.08.2021;
- Me shkresën nr. 198/5 prot, datë 27.08.2021 “*Kthim përgjigje për Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet* “Për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit” të Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 47/9 prot., datë 6.8.2021”.

Materialet e cituara më sipër si, Programi i Punës dhe Relacioni mbi masat e marra për zbatimin e programit të punës janë dërguar zyrtarisht dhe protokolluar në KLSH, me shkresën nr. 47/12, datë 30.08.2021, brenda afatit ligjor.

Në plan janë përcaktuar strukturat përgjegjëse dhe masat që do të ndërmerren për secilin nga 16 rekomandimet.

#### **III.3.Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 47/9 prot., datë 06.08.2021 (protokolluar në ASIG me shkresën nr. 198/1 prot, datë 09.08.2021), është dërguar “Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për, auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit” në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG”.

Me anë të shkresave nr. 294/15 prot, datë 07.02.2022, dhe nr. 294/14 prot, datë 07.02.2022 ASIG ka dërguar pranë KLSH-së “Dërgim informacioni mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe “Relacionin përfundimtar për zbatimin e programit të punës për rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditimit”, të protokolluara në KLSH me shkresën nr. 182 prot, datë 09.02.2022, në përmbushje të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**III.4.Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.**

<b>Nga të pranuarat</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
<b>Zbatuar</b>	9	56
<b>Zbatuar pjesërisht</b>	1	6
<b>Në proces</b>	6	38
<b>Nuk janë zbatuar</b>	0	0

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej **15** masa organizative dhe **1** masë shpërblim dëmi, nga të cilat janë pranuar **16** masa ose **100%**. Janë zbatuar plotësisht **9** prej tyre ose **56%**, janë në proces zbatimi **6** masa ose **38%**, është zbatuar pjesërisht **1** masë ose **6%**.

#### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**Nga ana e KLSH, i janë rekomanduar ASIG-ut 15 masa organizative dhe një masë për shpërblim dëmi. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 15 masa. Janë zbatuar 8 masa, janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative. Nga masat për shpërblim dëmi është pranuar dhe zbatuar plotësisht 1 masë.**

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve:

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi biznes planin strategjik të pesëvjeçarit 2015-2020, rezultoi se nuk janë kryer përditësime të ndryshimeve përgjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, për vitin 2020 nuk është dokumentuar arritja e objektivave të institucionit bazuar në pikën 3.1.3.

**1.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të ASIG të marrin masat, për rishikimin dhe përditësimin periodik të politikave në strategjinë për vitet 2020-2030 mbi “Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri”.

**1.2.Nga auditimi rezulton që:** ASIG ka ngritur grupin e punës, me urdhrin nr. 49 prot, datë 09.06.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e zbatimit të dokumentit të politikave të sektorit të Gjeoinformacionit”, por nga auditimi nuk u administrua asnjë dokumentacion tjetër mbi raportimin e grupit deri tani, pranë Këshillit të Ministrave. Grupi i punës është duke hartuar raportin e parë dhe njëkohësisht po hartohen pyetësorët për t’jua dërguar autoriteteve përgjegjëse në mënyrë që të merret një informacion sa më i plotë.

**Rekomandimi është në proces zbatimi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se ASIG nuk disponon raporte periodike mbi zbatimin e nenit 6, të rregullores “Gjeoportali Kombëtar”, miratuar me nr.390/7 Prot., datë 19.11.2018 dhe nenit 8 të rregullores “Mbi infrastrukturën TIK të ASIG hostuar pranë DataCenter-it Qeveritar”, miratuar me nr. 281 Prot., datë 02.09.2020, që kanë për qëllim matjen e ecurisë së institucionit.

**2.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa, për raportimin dhe dokumentimin e detyrimeve të përcaktuara në rregulloret e Gjeoportalit Kombëtar dhe Infrastrukturën TIK të ASIG, me qëllim zbatimin dhe sigurimin e gjurmës së auditimit mbi mbarëvajtjen dhe matjen e aktivitetit të institucionit.

**2.2.Nga auditimi rezulton që:** *Me shkresën nr. 198/8 prot, datë 01.09.2021 është ngritur grupi i punës për Raportimin e Zbatimit të Rregulloreve të Gjeoportalit Kombëtar dhe Infrastrukturën TIK të ASIG. Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar raportet mujore mbi kontrollin periodik të infrastrukturës TIK të ASIG, që është e hostuar pranë DataCenter-it Qeveritar. Raportet janë miratuar me shkresat përkatëse të cilat janë cituar më lart.*

**Rekomandimi është zbatuar**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se ASIG nuk disponon udhëzues apo rregullore, për menaxhimin e përdoruesve që aksesojnë shërbimet dhe funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar, nëpërmjet portalit e-Albania.

**3.1.Rekomandimi:** Strukturat Drejtuese në ASIG të hartojnë dhe publikojnë, për përdoruesit e web-it nga portali e-Albania një udhëzues, i cili të përmbajë informacionin e plotë mbi mënyrën e regjistrimit, format e regjistrimit, kur krijimi i përdoruesit është i nevojshëm, informimin e saktë dhe qartë mbi mënyrat e aksesimit si dhe të drejtat dhe detyrimet që ka çdo përdorues i krijuar nga ndërfaqja web.

**3.2.Nga auditimi rezulton që:** *Me anë të shkresës nr. 198/9 prot, datë 01.09.2021 drejtori i përgjithshëm i ASIG ka ngritur urdhrin nr. 71, datë 01.09.2021, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e udhëzuesit për përdoruesit e gjeoportalit kombëtar nëpërmjet e-Albania. Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar Udhëzuesin për përdoruesit e web-it që regjistrohen nëpërmjet portalit e-Albania në Gjeoportalin kombëtar. Pas hartimit dhe miratimit të udhëzuesit, ai është publikuar në gjeoportalin e ASIG, i cili është i aksesueshëm sipas linkut të sipërcituar.*

**Rekomandimi është zbatuar**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi strukturën e ASIG rezultoi se nga 3 specialistë në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar që përmban struktura, një vend është vakant, çfarë vë në rrezik arritjen e objektivave të këtij sektori.

**4.1.Rekomandimi:** ASIG të ndërmarrë masa, për mirë menaxhimin e burimeve njerëzore në plotësimin e vendeve vakante të Sektorit të Gjeoportalit Kombëtar, Drejtoria e GIS-it Kombëtar.

**4.2.Nga auditimi rezulton që:** *Me anë të shkresës nr. 4710 prot, datë 23.08.2021 të Departamentit të Administratës Publike, vendi vakant në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, Drejtoria e GIS-it Kombëtar është plotësuar.*

**Rekomandimi është zbatuar**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përshkrimet e punës të specialistëve, miratuar me shkresën nr.344/2 prot, datë 10.08.2018, rezultoi se një nga detyrat funksionale adresohet gabim tek specialisti në sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, pika ë. grupi i auditimit gjykon se, kjo detyrë nuk është adresuar në përputhje me njohuritë teknike dhe profesionale, që specialisti gjeodet disponon, për të ofruar sigurinë dhe mirë funksionimin e sistemeve IT, detyrë e cila i ngarkohet një pozicioni me formim në administrimin e sistemit të gjeoportalit.



**5.1.Rekomandimi:** ASIG të ndërmarrë masa për rishikimin e detyrave funksionale të punonjësve në drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, me qëllim adresimin e tyre sa më afër me formimeve profesionale.

**5.2.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 245 prot, datë 09.09.2021 drejtori i përgjithshëm i ASIG ka ngritur urdhrin nr. 78, datë 09.09.2021, për rishikimin dhe ndryshimin e përshkrimeve të punës së punonjësve të ASIG. Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar memon përkatëse drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG në të cilën janë përshkrimet e propozuara për ndryshime të përshkrimeve të punës së punonjësve. Me anë të shkresës nr. 294/2 prot, datë 28.10.2021 ndryshimet mbi përshkrimet e punës i janë dërguar sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për miratimin e tyre.

**Rekomandimi është zbatuar**

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi regjistrin e riskut që ka hartuar institucioni, në drejtim të teknologjisë së informacionit, rezulton se, në asnjë formë nuk janë identifikuar dhe dokumentuar risqe lidhur me sistemin ALBCORS.

**6.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa për identifikimin dhe dokumentimin e risqeve për sistemin ALBCORS, si pjesë e regjistrit të institucionit në mënyrë që të jenë identifikuar dhe adresuar rreziqet e mundshme që paraqiten në këtë sistem.

**6.2.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 198/7 prot, datë 01.09.2021 drejtori i përgjithshëm i ASIG ka ngritur urdhrin nr. 68, datë 01.09.2021, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumentit për menaxhimin e riskut të sistemit ALBCORS. Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar memon përkatëse drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG në të cilën është paraqitura e dokumentit për “Menaxhimin e Riskut të Sistemit ALBCORS”. Pas hartimit është bërë dhe miratimi i këtij dokumenti nga drejtori i përgjithshëm i ASIG në nëntor 2021.

**Rekomandimi është zbatuar**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Gjeoportali Kombëtar është pa mirëmbajtje prej datës 22.11.2018, veprim në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” dhe udhëzimin i Ministrisë së Inovacioni dhe Administratës Publike nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.

**7.1.Rekomandimi:** AKSHI të marrë masa për mirëmbajtjen dhe administrimin nga ana teknike të Gjeoportalit Kombëtarë.

**7.2.Rekomandimi:** AKSHI të identifikojë dhe dokumentojë të gjithë elementët e mirëmbajtjes dhe cilësisë së shërbimeve, të cilat i ofrohen ASIG-ut.

**7.3.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 182/2 prot, datë 02.09.2020 ASIG i ka kërkuar AKSHI-t miratimin e specifikimeve teknike për procedurën “Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar për ASIG”. Me shkresën nr. 245/28 prot, datë 13.10.2021, AKSHI i ka kthyer përgjigje ASIG mbi zbatimin e rekomandimeve të mësipërme, duke cituar se procedura për prokurimin e projektit me objekt “Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar” ku përfshihet dhe mirëmbajtja e Gjeoportalit Kombëtar është ende në proces prokurimi. Me shkresën nr. 305/1 prot, datë 16.11.2021 AKSHI ka njoftuar se do të realizohet procedura e prokurimit të projektit “Përmirësimi i Gjeoportalit Kombëtar” dhe nëpërmjet e-mailit zyrtar, AKSHI ka njoftuar ASIG se procedura e prokurimit ka përfunduar dhe se është lidhur kontrata me nr. 457 prot, datë 24.01.2022 për “Përmirësimin e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar”. Protokollat e komunikimit ndërmjet dy institucioneve mbi implementimin e kësaj kontrate, konkretisht: (-Shkresa nr. 70 prot, datë 24.02.2022 e drejtorit të përgjithshëm të ASIG për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe implementimin e kontratës “Përmirësimi i sistemit

të Gjeoportalit Kombëtar për ASIG”; -Shkresa nr. 74 prot, datë 24.02.2022 mbi përcjelljen e raportit fillestar mbi implementimin e kontratës; -Shkresa nr. 74/1 prot, datë 01.03.2022 kthim përgjigje mbi raportin fillestar; -Komunikimet me anë të postës elektronike; Kontrata nr. 457, datë 24.01.2022).

### **Rekomandimi është zbatuar**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve mbi marrëveshjen në nivelit të shërbimit nga ASIG me nr.189/1 prot. datë. 06.06.2019, me objekt: “Ofrimi i shërbimeve nga AKSHI për ASIG”, rezultoi se ASIG nuk e mat cilësinë e shërbimeve të AKSHI-t në kundërshtim me pikën 8.ç të udhëzimit nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.

**8.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa të menjëhershme për matjen dhe dokumentimin e cilësisë së shërbimeve që rrjedh si detyrim i marrëveshjes në nivel shërbimi me AKSHI-n.

**8.2.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 245/1 prot, datë 15.09.2021 ASIG i ka kërkuar AKSHI-t bashkëpunim për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, pasi për disa rekomandime kërkohet bashkëpunimi i të dy institucioneve për realizimin e tyre. Në lidhje me rekomandimin e mësipërm ASIG me anë të shkresës së cituara më lart i kërkon ASKHI-t dërgimin e raporteve periodike mujore mbi zbatimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit të lidhur ndërmjet dy institucioneve, nëpërmjet të cilave të sigurohet evidentimi i matjes dhe dokumentimit të cilësisë së shërbimeve, detyrime që rrjedhin nga marrëveshja e sipërcituar ndërmjet institucioneve.

Me shkresën nr. 245/28 prot, datë 13.10.2021, AKSHI i ka kthyer përgjigje ASIG mbi bashkëpunimin për zbatimin e rekomandimeve, duke cituar se “dërgimi i raporteve periodike mujore nuk ka qenë e përfshirë në këtë marrëveshje. Për më tepër, nuk ka asnjë vlerë të shtuar dërgimi i raporteve mujore nga AKSHI, duke qenë se ASIG ka një staf të dedikuar e të atashuar pranë ambienteve të institucionit për të ofruar suportin e nevojshëm”.

Me shkresën nr. 294/7 prot, datë 09.12.2021, ASIG i ka dërguar sërish shkresë zyrtare AKSHI-t për plotësimin e këtij rekomandimi, që kërkon bashkëpunimin e të dy institucioneve. Pas dërgimit të kësaj shkrese deri në momentin e hartimit të këtij akt verifikimi nuk u administrua asnjë kthim përgjigje nga AKSHI.

### **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së ndjekur për kryerjen e “back-up” mujor të sistemit të Gjeoportalit Kombëtar nga ASIG me Specialistin e IT të AKSHI-t, rezulton se procesi nuk dokumentohet dhe nuk kryhen teste periodike për vlefshmërinë e ruajtjes së të dhënave të sistemit.

**9.1.Rekomandimi:** ASIG të kryej analizimin e situatës së gjithë procesit të realizimit të Back Up dhe të marri masa të monitorojë dhe dokumentojë të gjithë këtë proces duke shtuar kryerjen e testeve periodike në vijimësi të marrëveshjeve me AKSHI-n.

**9.2.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 198/10 prot, datë 01.09.2021 drejtori i përgjithshëm i ASIG ka ngritur urdhrin nr. 72, datë 01.09.2021, për ngritjen e grupit të punës për analizimin dhe dokumentimin e procesit të back-up të sistemeve që administrohen nga ASIG. Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës me anë të memos me nr. 245/30 prot, datë 14.10.2021 i është drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG në të cilën shprehen se kanë kryer përditësimin e “Rregullores së infrastrukturës TIK të ASIG të hostuar në Datacenterin-in qeveritar”, ku ja përshkruar ndryshimet në paragrafët përkatëse. Pas hartimit është bërë dhe miratimi i kësaj rregulloreje nga drejtori i përgjithshëm i ASIG.

Gjithashtu në zbatim të urdhrin nr. 72, datë 01.09.2021 grupi i punës me anë të memos me nr. 245/31 prot, datë 14.10.2021 i është drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG në të cilën shprehen se kanë kryer përditësimin e “Rregullores së Gjeoportalit Kombëtar”, ku ja

*përshkruar ndryshimet në paragrafët përkatëse. Pas hartimit është bërë dhe miratimi i kësaj rregulloreje nga drejtori i përgjithshëm i ASIG.*

### ***Rekomandimi është zbatuar***

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat, dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion për proceset e punës, rezulton se ASIG nuk disponon paraqitje grafike, apo dokumentim të gjurmës së auditimit (logs) në sistemin e Gjeoportalit.

Gjurma elektronike audituese mbi veprimet që ka kryer çdo përdorues mungon, siguria e të dhënave është bazuar në integritetin e punonjësve, sepse sistemi nuk ofron gjurmë digjitale me qëllim adresimin e saktë të prekjes së të dhënave në rast të ndryshimit të tyre. Ky konstatim bazohet në faktin se fushat e të dhënave “*created by*” dhe “*modified by*”, që gjenden në tabelën e roleve, janë “NULL”, çfarë tregon se këto funksionalitete që kanë për qëllim ruajtjen e gjurmës së kryerjes së veprimeve në lidhje me ndryshimet mbi rolet, nuk janë vënë në funksion.

**10.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa, për përmirësimin e bazës së të dhënave në drejtimin e ruajtjes dhe sigurimit të gjurmës digjitale në zbatim të urdhrit ne.109, datë 10.06.2016, duke e konsideruar në termat e mirëmbajtjes të ofruar nga operatorë të jashtëm apo nga AKSHI, me konsideratën që zgjidhja të suportojë zhvillimet në drejtim të sistemit të GIS-it Kombëtar, për të cilin është menduar të përdoret e njëjta bazë të dhënash bazuar në faktin që është një bazë të dhënash shtetërore.

**10.2.Nga auditimi rezulton që:** *Me anë të shkresës nr. 182/5 prot, datë 05.08.2021 ASIG i ka dërguar AKSHI-t, versionin e ri të dokumentit të specifikimeve teknike për mirëmbajtjen e Gjeoportalit Kombëtar. Me datë 01.02.2022, me anë adresës zyrtare elektronike AKSHI ka njoftuar ASIG për lidhjen e kontratës me nr. 457 prot, datë 24.01.2022, “Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar”, mbi të cilën ASIG ka parashikuar përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar dhe mirëmbajtjen e tij.*

### ***Rekomandimi është në proces zbatimi***

#### **11.Gjetje nga auditimi:**

1. Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në Gjeoportalin Kombëtar rezultuan se disa prej të dhënave nuk janë konform standardit të miratuar, por janë publikuar në Gjeoportali me shënimin “Të dhëna jo konform standardit...”, renditur si më poshtë:

- Rrjetet e Transportit, Infrastruktura rrugore (ARRSH), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- AMBU, Lejet për Hidrocentrale, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- AMBU, Përdorimi i ujit, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- AMBU, Inbotilim, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- AMBU, Pus shpimet, me institucion gjenerues Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMVV), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të tipologjive, strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;
- Ndërtesat (ASHK), me institucion gjenerues Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për: strukturën e emërtimeve dhe numrit të attributeve, katalogut të tipologjisë dhe cilësisë së të dhënave;

2. Nga auditimi u konstatua se janë publikuar pa informacionin Gjeohapësinor (metadatën):

- Përdorimi i Tokës (Zona e mbulimit);

- Tipet e Tokës (Zona e mbulimit);

**11.1.Rekomandimi:** ASIG si institucion standardizues dhe publikues i të dhënave Gjeohapësinore të marrë masa kontrolluese dhe kundërshtuese për mos publikimin e të dhënave hapësinore në rastet kur metadata nga institucioni dërgues mungon, si e vetmja mënyrë, për të parandaluar publikimin e informacioneve jo të plota gjeohapësinore.

**11.1.1.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 198/12 prot, datë 01.09.2021 drejtori i përgjithshëm i ASIG ka ngritur urdhrin nr. 74, datë 01.09.2021, për ngritjen e grupit të punës për kontrollin dhe rishikimin e metadatave të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.

Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar memon nr. 245/19 prot, datë 04.10.2021 drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG në të cilën grupi shprehet se ka kryer kontrollin dhe rishikimin e metadatave për të dhënat dhe shërbimet Gjeohapësinore të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.

**Rekomandimi është zbatuar**

**11.2.Rekomandimi:** ASIG si institucion përgjegjës, për respektimin e standardeve gjeohapësinore, të respektojë hartën e proceseve të punës duke i kthyer përgjigje çdo subjekti me të dhëna të detajuara mbi parregullsitë e konstatuara nga kontrollet e konformitetit.

**11.2.2.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të urdhrin nr. 80, datë 30.08.2018 të drejtorit të përgjithshëm të ASIG është ngritur grupi i punës për përgatitjen e udhëzuesit teknik “Për kontrollin e sistemeve të informacionit Gjeohapësinor”. Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar memon nr. 372/1 prot, datë 15.11.2018 drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG në të cilën grupi shprehet se ka ri përgatitur draftin e udhëzuesit teknik për kontrollin e të dhënave/sistemeve të informacionit gjeohapësinor dhe përfshirjen e tyre në GIS-in Kombëtar. Pas hartimit është bërë dhe miratimi i këtij udhëzuesi teknik nga drejtori i përgjithshëm i ASIG. Në këtë akt rregullues ASIG mbështet dhe në realizimin e Kontrollit të konformitetit të metadataës.

Në vijimësi ASIG shprehet se, në rastin e evidentimit të mos konfirmimitit me standardet e Gjeoinformacionit të miratuara, nuk do të publikojë të dhënat në Gjeoportalin Kombëtar por do t'i kthejë përgjigje zyrtare autoritetit publik përgjegjës, ku do të citohen në mënyrë të detajuar pasaktësitë ose mungesat e evidentuara.

**Rekomandimi është zbatuar**

**11.3.Rekomandimi:** ASIG si institucion përgjegjës, për respektimin e standardeve gjeohapësinore, të respektojë hartën e proceseve të punës duke i kthyer përgjigje çdo subjekti me të dhëna të detajuara mbi parregullsitë e konstatuara nga kontrollet e konformitetit.

**11.3.3.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të urdhrin nr. 80, datë 30.08.2018 të drejtorit të përgjithshëm të ASIG është ngritur grupi i punës për përgatitjen e udhëzuesit teknik “Për kontrollin e sistemeve të informacionit Gjeohapësinor”. Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar memon nr. 372/1 prot, datë 15.11.2018 drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG në të cilën grupi shprehet se ka ri përgatitur draftin e udhëzuesit teknik për kontrollin e të dhënave/sistemeve të informacionit gjeohapësinor dhe përfshirjen e tyre në GIS-in Kombëtar. Pas hartimit është bërë dhe miratimi i këtij udhëzuesi teknik nga drejtori i përgjithshëm i ASIG. Në këtë akt rregullues ASIG mbështet në kontrollin e të dhënave/sistemeve të informacionit gjeohapësinor dhe përfshirjen e tyre në GIS-in Kombëtar. Për të demonstruar respektimin e hartës së proceseve në kthimin e përgjigjeve të çdo subjekti me të dhëna të detajuara mbi parregullsitë e konstatuara nga kontrollet e konformitetit, ASIG ka sjellë për shembull me anë të shkresës nr. 306/2, datë 28.01.2022 kërkesën për bashkëpunim për standardizimin e të dhënave me AKEP, “mbi infrastrukturën urbane dhe shërbimet qeveritare, infrastruktura e telekomunikacionit. Pasi ASIG ka evidentuar probleme me gjeometrinë si dhe nuk janë zbatuar

rregullat topologjike standarde në software ose në sistemet WebGis për rrjedhojë ASIG shprehet se, këto të dhëna nuk mund të publikohen në gjeoportalin.

**Rekomandimi është zbatuar**

**11.4.Rekomandimi:** ASIG në bashkëpunim me institucionin përgjegjës të plotësojnë metadatën për të dhënat gjeohapësinore të shtresave:

- Përdorimi i Tokës (Zona e mbulimit);
- Tipet e Tokës (Zona e mbulimit);

*Përgjigja e subjektit:* Përsa i përket dy shtresave, ato janë plotësuar me metadatat përkatëse. Në link-et e mëposhtme gjeni metadatat e publikuara:

- Përdorimi i Tokës (Zona e mbulimit);

*Link:* <https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search.jsessionid=BFAABEC6EDCD37EC76E84B4BE17A30EC?auto=true#/metadatas/7e123ba6-0a0f-4fcc-b4b1-15bb86698843>.

- Tipet e Tokës (Zona e mbulimit);

*Link:* <https://geoportal.asig.gov.al/geonetwork/srv/alb/catalog.search?auto=true#/metadatas/b7f5ec71-ac22-4dbc-99a2-68834922db9b>.

**11.4.4.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 198/12 prot, datë 01.09.2021 drejtori i përgjithshëm i ASIG ka ngritur urdhrin nr. 74, datë 01.09.2021, për ngritjen e grupit të punës për kontrollin dhe rishikimin e metadatave të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.

Në zbatim të urdhrin të cituar më lart, grupi i punës ka kryer kontrollin dhe rishikimin dhe plotësimin e metadatave për të dhënat dhe shërbimet Gjeohapësinore të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar. Më lart janë cituar link-et përkatëse nga të cilat mund të aksesohen shtresat ku janë plotësuar metadatat.

**Rekomandimi është zbatuar**

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në Gjeoportalin kombëtar rezulton se, mungojnë të dhënat gjeohapësinore dhe metadatat, për temat dhe autoritetin përgjegjës në tabelën më poshtë:

Nr.	Tema	Autoriteti Përgjegjës
1	Pedologjia	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)
2	Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tyre	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
3	Infrastruktura industriale	Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)
4	Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura	Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
5	Zonat me përdorim të kufizuar	Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
6	Zonat me rreziqe natyrore	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile
7	Kushtet atmosferike	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
8	Meteorologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
9	Hidrologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
10	Detet	Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare)
11	Zonat ekologjike	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
12	Habitatet	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
13	Shpërndarja e specieve	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

**12.1.Rekomandimi:** ASIG në bashkëpunim me autoritet përgjegjës për temat e mësipërme që zotërojnë informacione gjeohapësinore, e që ende nuk janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar, të cilat janë:

- Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB);
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);
- Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE);

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);
- Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR);
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile;
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
- Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare);
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Të iniciojnë procesin e publikimit të informacionit, pra metadatën përkatëse, si një e drejtë e informimit, për të dhënat të cilat jo vetëm që janë parashikuar në aktet ligjore por nuk do të kenë së shpejti ndonjë sistemi informatik.

**12.2.Nga auditimi rezulton që:** *Me anë të shkresave zyrtare (shkresat nr. 245/3, datë 20.09.2021; nr. 245/11, datë 20.09.2021; nr. 245/4, datë 20.09.2021; nr. 245/5, datë 20.09.2021; nr. 245/6, datë 20.09.2021; nr. 245/8, datë 20.09.2021; nr. 245/10, datë 20.09.2021; nr. 245/7, datë 20.09.2021; nr. 245/9, datë 20.09.2021) si dhe të cituara dhe nga subjekti, ASIG ka kërkuar nga institucionet e lartpërmendura, informacion gjeohapësinor të bashkëlidhur me metadatën përkatëse sipas specifikave që institucionet mbulojnë dhe trajtojnë për publikim e tyre në Gjeoportalin Kombëtar. Me anë të shkresave zyrtare (shkresat nr. 294, datë 26.10.2021; nr. 245/24, datë 11.10.2021; nr. 245/25, datë 11.10.2021; nr. 245/22, datë 07.10.2021; nr. 245/21, datë 07.10.2021), disa nga këto institucione kanë kthyer përgjigje, por pjesa më e madhe e tyre shprehen që nuk disponojnë informacion gjeohapësinor në lidhje me çështjet apo fushat që secili prej këtyre institucioneve trajton.*

### **Rekomandimi është në proces zbatimi**

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollet e implementuara në sistemin e Gjeoportalit Kombëtar u konstatuan mangësi në drejtim të identifikimit dhe saktësisimit, si:

- Nuk jepet informacion nëse ndërtesa ose prona është publike apo private çfarë i shërben informacionit më të detajuar dhe më të plotë të përdoruesve të portalit;
- Mungon standardizimi i shkrimit për të dhëna unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj., çfarë krijon pengesa për raportime dhe statistika të ndryshme që vetë institucionit mund ti nevojiten;
- Të dhënat e institucioneve që janë importuar në sistem, nuk i ‘u janë përmbajtur emërtimeve të të dhënave sipas standardit sepse baza e të dhënave për çdo skemë nuk përmban informacionet detyruese të standardit, por rekordi importohet me informacionin dhe emërtimin e fushave që i ka dhënë vetë subjekti dërgues. Prezenca e të dhënave jo të plota dhe mungesa e përcaktimit të të dhënave detyruese për çdo klasë të dhënash, ka krijuar mundësinë e regjistrimit të të dhënave jo të plota, si në rastin e tabelën adr\_ndertese: ka të dhëna që ju mungon emri i rrugës, kur është populluar kodi i rrugës apo shape\_area;

**13.1.Rekomandimi:** ASIG në bashkëpunim me autoritet përgjegjëse që gjenerojnë informacion për secilën temë, të marrin në konsideratë sistemimet e bazës së të dhënave në lidhje me:

- Shtimin e informacionit nëse ndërtesa ose prona është publike apo private nga adresari apo ASHK, për ato raste kur ky informacion është publik dhe pa pagesë;
- Standardizimi i shkrimit për të dhëna unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj.;
- Plotësimin dhe sigurimin e të dhënave që përcaktojnë standardet për çdo klasë, ku më parë të jenë përcaktuar se cilat janë të dhënat detyruese dhe cilat janë të dhënat plotësuese që kërkohen të plotësojnë subjektet për publikimin e informacionit gjeohapësinor.

**13.2.Nga auditimi rezulton që:** ASIG, me anë të shkresës nr. 245/2 prot, datë 16.09.2021 i ka kërkuar ASHK, bashkëpunim për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, duke qenë se ASHK është autoriteti përgjegjës për informacionit nëse ndërtesa ose prona është publike apo private si dhe për standardizimin e të dhënave gjeohapësinore që ata disponojnë. ASHK-ja nuk e bën të mundur publikimin e këtij informacioni. Duke qenë se në specifikimet teknike të standardeve të miratuara me VKM-të përkatëse, VKM-ja nr. 359, datë 11.05.2016 “Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: “Ndërtesat”” dhe VKM-ja nr. 321, datë 27.04.2016 “Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: “Parcelat kadastrale””, nuk paraqitet i specifikuar statusi juridik i pronës ose ndërtesës. Në raste të tilla kur standardi nuk e përfshin një specifikim të tillë është vendim i institucionit përgjegjës në qoftë se do të publikojë të dhëna shtesë apo jo. Në lidhje me standardizimin e të dhënave unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj, janë kontrolluar shtresat që janë të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar dhe janë evidentuar pasaktësi në standardizimin e shkrimit.

- Janë vënë në dijeni autoritetet publike përgjegjëse për të dhënat gjeohapësinore sipas temave të standardeve përkatëse, në lidhje me përcaktimin e detyrueshmërisë së paraqitjes së të dhënave duke u bazuar në standardet e miratuara me VKM-të përkatëse.
- Me shkresën nr. 121/1 prot, datë 17.01.2022 në ASIG kanë ardhur të dhënat gjeohapësinore të standardizuara nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore – AMBU ku me CD janë dërguar (shapefilet për lejet dhe metadata për këto të dhëna) dhe më pas është realizuar standardizimi i shtresave të ardhura.
- Me shkresën nr. 318/1 prot, datë 09.12.2021 ASIG ka njoftuar Autoritetin Rrugor Shqiptar për të depozituar pranë ASIG të dhënat Gjeohapësinore që ata disponojnë, konform standardit të miratuar për temën: “Rrjetet e transportit”.

### **Rekomandimi është në proces zbatimi**

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve rezultoi se:

- Janë krijuar më shumë se 1 përdorues për të njëjtin punonjës, përfshirë dhe punonjësin e firmës që ka ofruar mirëmbajtjen dhe rezultojnë aktivë edhe pse respektivisht testimet e punonjësve të brendshëm kanë përfunduar dhe kontrata e mirëmbajtjes.
- Mungon identifikimi i përdoruesve nëse ai është punonjës publik apo privat, si një ndarje e rëndësishme e cila i shërben analizimit të të dhënave dhe vlerësimit mbi përdorimin e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar.
- Nuk janë përcaktuar fushat e detyrueshme në formën e krijimit të përdoruesit nëpërmjet web-it, në mënyrë që vetë përdoruesi të kuptojë rëndësinë e plotësimit të tyre kur kërkon të krijojë një përdorues të sistemit të Gjeoportalit nëpërmjet web-it.

**14.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa për:

- Të hartojë e zbatojë rregulla të mirë përcaktuara mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm si përdorues të sistemit.
- Identifikimin e saktë nëse përdoruesit janë të brendshëm, të institucioneve publike apo privat;
- Të identifikojë dhe ti sinjalizojë me simbole të dukshme të dhënat e detyrueshme në formën e krijimit të përdoruesit nga web.

**14.2.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 198/14 prot, datë 01.09.2021 drejtori i përgjithshëm i ASIG ka ngritur urdhrin nr. 76, datë 01.09.2021, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullave për identifikimin e përdoruesve të gjeoportalit kombëtar dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre. Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar memon nr. 294/13 prot, datë 31.01.2022 drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG me anë të secilës i kanë dërguar rregulloren përkatëse. Rregullorja për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të

përdoruesve të gjeoportalit kombëtar është miratuar nga drejtori i përgjithshëm i ASIG me datë 31.01.2022.

Në lidhje me pikat 2 dhe 3 të rekomandimit ASIG shprehet se do të kryhen në vijimësi nga kompania kontraktore e mirëmbajtjes, konkretisht sipas kontratës me nr. 457, datë 24.01.2022, "Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar". Për këtë qëllim me anë të shkresës nr. 182/5 prot, datë 05.08.2021 ASIG i ka dërguar AKSHI-t, versionin e ri të dokumentit të specifikimeve teknike për mirëmbajtjen e Gjeoportalit Kombëtar. Me datë 01.02.2022, me anë adresës zyrtare elektronike AKSHI ka njoftuar ASIG për lidhjen e kontratës me nr. 457 prot, datë 24.01.2022, "Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar", mbi të cilën ASIG ka parashikuar përmirësimin e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar dhe mirëmbajtjen e tij.

### **Rekomandimi është në proces zbatimi**

**15.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e popullimit të metadatës nga ASIG, u konstatuan disa problematika të cilat tregojnë për parregullsi në plotësimin e një informacioni kaq të rëndësishëm siç është metadata e informacionit gjeohapësinor për faktin se aty gjendet shpjegimi mbi çdo të dhënë informative gjeohapësinore të publikuar të vendit, por njëkohësisht si e dhënë parësore e sistemit të Gjeoportali që është dhe baza e ndërtimit të GIS Kombëtar.

Në mënyrë të njëpasnjëshme janë renditur çështjet e konstatuara që kërkojnë marrjen e masave nga ana e subjektit:

- Plotësimi mbi të dhënë "Kontakti për burimin" është plotësuar në disa variante: Krijuesi, Autori apo Pronari; Në rastet kur është plotësuar "Krijuesi", nuk është plotësuar institucioni që e administron apo posedon këtë të dhënë të krijuar nga dikush tjetër.

- Në një rast, por nuk përjashtohet mundësia të ketë dhe raste të tjera u konstatua se "Kontakti për burimin" është vendosur ASIG në vend të INSTAT;

- Konformiteti me standardet nuk shënohet tek "Përputhshmëria" pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, por shënohet tek "Abstrakti i burimit";

- "Përputhshmëria" pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, nuk është përfshirë tek informacioni i shkurtuar, në mënyrë që të publikojë në mënyrë të dukshme për çdo përdorues se sa konform standardit është kjo e dhënë;

- "Kushtet e aksesimit dhe përdorimit" pika 8.1 në tabelën 1, nuk është e paraqitur në metadatë;

- "Përputhshmëria" pika 7 në tabelën 1 është emërtuar në metadatë si "Kualitet" dhe popullohet me një të dhënë standarde që është standardi i INSPIRE;

- Nuk jepet informacion nëse shtresa e aksesuar ka mundësi për download;

- Në disa raste nuk është shënuar telefoni i kontaktit;

- Gjuha e përdorur në metadatë është herë në Shqip e herë në Anglisht dhe jo e përkthyer në mënyrë të përshtatshme;

- Nga ana vizuale "Informacioni" nuk tregon dukshëm dhe në mënyrë të zgjedhur informacion për lexuesin, si institucioni nga e cila kjo e dhënë buron, konformiteti etj. Në rastet e institucioneve që nuk kanë përditësuar informacionin gjeohapësinor, Informacioni të dalë aktiv kur sapo përdoruesi të zgjedhë shtresën, duke i dhënë mundësinë përdoruesit të lexojë së pari metadatën për këtë shtresë e më pas të mund të navigojë.

**15.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa të menjëhershme për sistemimin dhe rregullimin e informacionit gjeohapësinor në të gjitha rastet që janë konstatuar gabime në plotësimin e tyre si numrat e kontaktit apo kontakti i saktë mbi burimin.

**15.1.1.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 198/12 prot, datë 01.09.2021 drejtori i përgjithshëm i ASIG ka ngritur urdhrin nr. 74, datë 01.09.2021, për ngritjen e grupit të punës për kontrollin dhe rishikimin e metadatave të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.

Në zbatim të këtij urdhri grupi i punës ka hartuar memon nr. 245/19 prot, datë 04.10.2021 drejtuar drejtorit të përgjithshëm të ASIG në të cilën grupi shprehet se ka kryer kontrollin dhe



rishikimin e metadatave për të dhënat dhe shërbimet Gjeohapësinore të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.

#### **Rekomandimi është zbatuar**

**15.2.Rekomandimi:** ASIG të marrë në konsideratë rregullimin dhe sistemimin e informacionit gjeohapësinor në lidhje me:

- Përkthimin e fushave në gjuhën shqip për ato që rezultojnë vetëm në anglisht;
- Dhënien e informacionit nëse shtresa e aksesuar mund të download-ohet;
- Riorganizimin nga ana vizuale dhe informative të Informacionit të kufizuar që paraqitet për çdo shtresë;
- Plotësimin në “Kushtet e aksesimit dhe përdorimit”;
- Plotësimin e të dhënës së përputhshmërisë dhe përfshirjen e saj në informacionin paraprak të çdo shtrese që i paraqitet përdoruesit në vendin e duhur.
- “Kontakti me burimin” të plotësohet me institucionin nga i cili ASIG i ka marrë të dhënat që po publikohen, ndërsa informacioni mbi gjenerimin historik të të dhënave të jetë informacion i dhënë nëpërmjet abstraktit për atë kohë sa është e pamundur nëpërmjet kësaj forme të kemi të renditur të gjitha burimet.

**15.2.2.Nga auditimi rezulton që:** Në lidhje me pikat e rekomandimit të mësipërm, ASIG shprehet se do të kryhen në vijimësi nga kompania kontraktore e mirëmbajtjes, konkretisht sipas kontratës me nr. 457, datë 24.01.2022, “Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar”. Për këtë qëllim me anë të shkresës nr. 182/5 prot, datë 05.08.2021 ASIG i ka dërguar AKSHI-t, versionin e ri të dokumentit të specifikimeve teknike për mirëmbajtjen e Gjeoportalit Kombëtar. Me datë 01.02.2022, me anë adresës zyrtare elektronike AKSHI ka njoftuar ASIG për lidhjen e kontratës me nr. 457 prot, datë 24.01.2022, “Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar”, mbi të cilën ASIG ka parashikuar përmirësimin e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar dhe mirëmbajtjen e tij.

#### **Rekomandimi është në proces zbatimi**

### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Printim Broshura” me fond limit 237.000 lekë pa TVSH rezultoi se, dorëzimi i shërbimit nuk është realizuar në Afatet e përcaktuara në Ftesën për ofertë dhe KPVV duhet të mbante penalitet mbi vonesën për dorëzimin e shërbimit nga OE Dhimitraq Kosta.

**1.1. Rekomandimi:** ASIG të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ato ligjore për arkëtimin e vlerës 2.136 Lekë nga OE Kujtim Drizari, vlerë e cila është përlogaritur si penalitet për mos dorëzim brenda afatit të shërbimit.

**1.2.Nga auditimi rezulton që:** Me anë të shkresës nr. 241 prot, datë 01.09.2021, ASIG i ka dërguar njoftim për paraqitje, për njohjen me Raportin e Auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” OE Kujtim Drizari. Pas njohjes me raportin e auditimit OE me datë 03.09.2021 ka kryer pagesën e vlerës 2.136 lekë për llogari të ASIG, pranë Bankës Raiffeisen, me faturë për arkëtim me nr. 2, datë 03.09.2021.

#### **Rekomandimi është zbatuar**

**Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Akt Verifikimi nr.1, datë 04.03.2022 protokolluar në ASIG me nr. 294/21 prot datë 04.03.2022. si dhe është trajtuar në faqet 3-21 të Projekt Raportit të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara 6-mujorin e parë të vitit 2021” mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit.**

**Përmbledhëse e të gjitha masave**

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime Gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
<b>MASA ORGANIZATIVE</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>0</b>
<b>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

#### IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes ASIG-ut i janë rekomanduar 15 masa organizative dhe një masë për shpërbllim dëmi. Nga auditimi rezultoi se, nga masat organizative janë zbatuar 8 masa, janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative. Nga masat për shpërbllim dëmi janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 1 masë.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi si më poshtë:

##### A. MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve mbi marrëveshjen në nivelit të shërbimit nga ASIG me nr.189/1 prot. datë. 06.06.2019, me objekt: “Ofrimi i shërbimeve nga AKSHI për ASIG”, rezultoi se ASIG nuk e mat cilësinë e shërbimeve të AKSHI-t në kundërshtim me pikën 8.ç të udhëzimit nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.

**1.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa të menjëhershme për matjen dhe dokumentimin e cilësisë së shërbimeve që rrjedh si detyrim i marrëveshjes në nivel shërbimi me AKSHI-n.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi biznes planin strategjik të pesëvjeçarit 2015-2020, rezultoi se nuk janë kryer përditësime të ndryshimeve përgjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, për vitin 2020 nuk është dokumentuar arritja e objektivave të institucionit bazuar në pikën 3.1.3.

**2.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të ASIG të marrin masat, për rishikimin dhe përditësimin periodik të politikave në strategjinë për vitet 2020-2030 mbi “Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri”.

*Në vijimësi*

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat, dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion për proceset e punës, rezultoi se ASIG nuk disponon paraqitje grafike, apo dokumentim të gjurmës së auditimit (logs) në sistemin e Gjeoportalit.

Gjurma elektronike audituese mbi veprimet që ka kryer çdo përdorues mungon, siguria e të dhënave është bazuar në integritetin e punonjësve, sepse sistemi nuk ofron gjurmë digjitale me qëllim adresimin e saktë të prekjes së të dhënave në rast të ndryshimit të tyre. Ky konstatim bazohet në faktin se fushat e të dhënave “created by” dhe “modified by”, që gjenden në tabelën e roleve, janë “NULL”, çfarë tregon se këto funksionalitete që kanë për qëllim ruajtjen e gjurmës së kryerjes së veprimeve në lidhje me ndryshimet mbi rolet, nuk janë vënë në funksion.

**3.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa, për përmirësimin e bazës së të dhënave në drejtimin e ruajtjes dhe sigurimit të gjurmës digjitale në zbatim të urdhrit ne.109, datë 10.06.2016, duke e konsideruar në termat e mirëmbajtjes të ofruar nga operatorë të jashtëm apo nga AKSHI, me konsideratën që zgjidhja të suportojë zhvillimet në drejtim të sistemit të GIS-it Kombëtar, për të cilin është menduar të përdoret e njëjta bazë të dhënash bazuar në faktin që është një bazë të dhënash shtetërore.

*Në vijimësi*

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në Gjeoportalin kombëtar rezultoi se, mungojnë të dhënat gjeohapësinore dhe metadat, për temat dhe autoritetin përgjegjës në tabelën më poshtë:

Nr.	Tema	Autoriteti Përgjegjës
1	Pedologjia	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)
2	Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tyre	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)

3	Infrastruktura industriale	Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)
4	Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura	Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
5	Zonat me përdorim të kufizuar	Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
6	Zonat me rreziqe natyrore	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile
7	Kushtet atmosferike	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
8	Meteorologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
9	Hidrologjia	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
10	Detet	Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare)
11	Zonat ekologjike	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
12	Habitatet	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
13	Shpërndarja e specieve	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

**4.1.Rekomandimi:** ASIG në bashkëpunim me autoritet përgjegjëse për temat e mësipërme që zotërojnë informacione gjeohapësinore, e që ende nuk janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar, të cilat janë:

- Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB);
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);
- Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);
- Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR);
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile;
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
- Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare);
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Të iniciojnë procesin e publikimit të informacionit, pra metadatën përkatëse, si një e drejtë e informimit, për të dhënat të cilat jo vetëm që janë parashikuar në aktet ligjore por nuk do të kenë së shpejti ndonjë sistemi informatik.

*Në vijimësi*

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollet e implementuara në sistemin e Gjeoportalit Kombëtar u konstatuan mangësi në drejtim të identifikimit dhe saktësisht, si:

- Nuk jepet informacion nëse ndërtesa ose prona është publike apo private çfarë i shërben informacionit më të detajuar dhe më të plotë të përdoruesve të portalit;
- Mungon standardizimi i shkrimit për të dhëna unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj., çfarë krijon pengesa për raportime dhe statistika të ndryshme që vetë institucionit mund ti nevojiten;
- Të dhënat e institucioneve që janë importuar në sistem, nuk i 'u janë përmbajtur emërtimeve të të dhënave sipas standardit sepse baza e të dhënave për çdo skemë nuk përmban informacionet detyruese të standardit, por rekordi importohet me informacionin dhe emërtimin e fushave që i ka dhënë vetë subjekti dërgues. Prezenca e të dhënave jo të plota dhe mungesa e përcaktimit të të dhënave detyruese për çdo klasë të dhënash, ka krijuar mundësinë e regjistrimit të të dhënave jo të plota, si në rastin e tabelën adr\_ndertese: ka të dhëna që ju mungon emri i rrugës, kur është populluar kodi i rrugës apo shape\_area;

**5.1.Rekomandimi:** ASIG në bashkëpunim me autoritet përgjegjëse që gjenerojnë informacion për secilën temë, të marrin në konsideratë sistemit e bazës së të dhënave në lidhje me:

- Shtimin e informacionit nëse ndërtesa ose prona është publike apo private nga adresari apo ASHK, për ato raste kur ky informacion është publik dhe pa pagesë;
- Standardizimi i shkrimit për të dhëna unike si emrat e qyteteve, emrat e prefekturave, nënprefekturave, emrat e muajve të vitit etj.;
- Plotësimin dhe sigurimin e të dhënave që përcaktojnë standardet për çdo klasë, ku më parë të jenë përcaktuar se cilat janë të dhënat detyruese dhe cilat janë të dhënat plotësuese që kërkohen të plotësojnë subjektet për publikimin e informacionit gjeohapësinor.

### *Në vijimësi*

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve rezultoi se:

- Janë krijuar më shumë se 1 përdorues për të njëjtin punonjës, përfshirë dhe punonjësin e firmës që ka ofruar mirëmbajtjen dhe rezultojnë aktivë edhe pse respektivisht testimet e punonjësve të brendshëm kanë përfunduar dhe kontrata e mirëmbajtjes.
- Mungon identifikimi i përdoruesve nëse ai është punonjës publik apo privat, si një ndarje e rëndësishme e cila i shërben analizimit të të dhënave dhe vlerësimit mbi përdorimin e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar.
- Nuk janë përcaktuar fushat e detyrueshme në formën e krijimit të përdoruesit nëpërmjet web-it, në mënyrë që vetë përdoruesi të kuptojë rëndësinë e plotësimit të tyre kur kërkon të krijojë një përdorues të sistemit të Gjeoportalit nëpërmjet web-it.

**6.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë masa për:

- Të hartojë e zbatojë rregulla të mirë përcaktuara mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm si përdorues të sistemit.
- Identifikimin e saktë nëse përdoruesit janë të brendshëm, të institucioneve publike apo privat;
- Të identifikojë dhe ti sinjalizojë me simbole të dukshme të dhënat e detyrueshme në formën e krijimit të përdoruesit nga web.

### *Në vijimësi*

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e popullimit të metadatës nga ASIG, u konstatuan disa problematika të cilat tregojnë për parregullsi në plotësimin e një informacioni kaq të rëndësishëm siç është metadata e informacionit gjeohapësinor për faktin se aty gjendet shpjegimi mbi çdo të dhënë informative gjeohapësinore të publikuar të vendit, por njëkohësisht si e dhënë parësore e sistemit të Gjeoportali që është dhe baza e ndërtimit të GIS Kombëtar. Në mënyrë të njëpasnjëshme janë renditur çështjet e konstatuara që kërkojnë marrjen e masave nga ana e subjektit:

- Plotësimi mbi të dhënë "Kontakti për burimin" është plotësuar në disa variante: Krijuesi, Autori apo Pronari; Në rastet kur është plotësuar "Krijuesi", nuk është plotësuar institucioni që e administron apo posedon këtë të dhënë të krijuar nga dikush tjetër.
- Në një rast, por nuk përjashtohet mundësia të ketë dhe raste të tjera u konstatua se "Kontakti për burimin" është vendosur ASIG në vend të INSTAT;
- Konformiteti me standardet nuk shënohet tek "Përputhshmëria" pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, por shënohet tek "Abstrakti i burimit";
- "Përputhshmëria" pika 7 sipas tabelës 1 në VKM nr.1077, datë 23.12.2015, nuk është përfshirë tek informacioni i shkurtuar, në mënyrë që të publikojë në mënyrë të dukshme për çdo përdorues se sa konform standardit është kjo e dhënë;
- "Kushtet e aksesimit dhe përdorimit" pika 8.1 në tabelën 1, nuk është e paraqitur në metadatë;
- "Përputhshmëria" pika 7 në tabelën 1 është emërtuar në metadatë si "Kualitet" dhe popullohet me një të dhënë standarde që është standardi i INSPIRE;
- Nuk jepet informacion nëse shtresa e aksesuar ka mundësi për download;
- Në disa raste nuk është shënuar telefoni i kontaktit;

- Gjuha e përdorur në metadatë është herë në Shqip e herë në Anglisht dhe jo e përkthyer në mënyrë të përshtatshme;

- Nga ana vizuale “Informacioni” nuk tregon dukshëm dhe në mënyrë të zgjedhur informacion për lexuesin, si institucioni nga e cila kjo e dhënë buron, konformiteti etj. Në rastet e institucioneve që nuk kanë përditësuar informacionin gjeohapësinor, Informacioni të dalë aktiv kur sapo përdoruesi të zgjedhë shtresën, duke i dhënë mundësinë përdoruesit të lexojë së pari metadatën për këtë shtresë e më pas të mund të navigojë.

**7.1.Rekomandimi:** ASIG të marrë në konsideratë rregullimin dhe sistemimin e informacionit gjeohapësinor në lidhje me:

- Përkthimin e fushave në gjuhën shqip për ato që rezultojnë vetëm në anglisht;

- Dhënien e informacionit nëse shtresa e aksesuar mund të download-ohet;

- Riorganizimin nga ana vizuale dhe informative të Informacionit të kufizuar që paraqitet për çdo shtresë;

- Plotësimin në “Kushtet e aksesimit dhe përdorimit”;

- Plotësimin e të dhënës së përputhshmërisë dhe përfshirjen e saj në informacionin paraprak të çdo shtrese që i paraqitet përdoruesit në vendin e duhur.

- “Kontakti me burimin” të plotësohet me institucionin nga i cili ASIG i ka marrë të dhënat që po publikohen, ndërsa informacioni mbi gjenerimin historik të të dhënave të jetë informacion i dhënë nëpërmjet abstraktit për atë kohë sa është e pamundur nëpërmjet kësaj forme të kemi të renditur të gjitha burimet.

*Në vijimësi*

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është trajtuar në faqet 22-25 të Projekt Raportit të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara 6-mujorin e parë të vitit 2021” mbi të cilin janë paraqitur komente/observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 227/2 datë 04.04.2022.*

### **1. Pretendimi i subjektit (mbi rekomandimin 1.1):**

ASIG, siç jemi shprehur në kthimin e përgjigjes për kërkesën për informacion/dokumentacion për “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme në 6-mujorin e parë të vitit 2021”, në zbatim të pikës 8, germa dh, të udhëzimit nr. 1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, i është drejtuar në datën 15.09.2021, zyrtarisht AKSHI-t me kërkesë për dërgimin nga këta të fundit të raporteve periodike mbi zbatimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (SLA)....

\*\*\*

Për arsyet e sipërcituara ASIG ka plotësuar të gjitha detyrimet që i takojnë dhe për realizimin e rekomandimit të mësipërm përgjegjësia duhet t’i adresohet AKSHI-t, e cila nuk ka dërguar raportimet periodike mbi zbatimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (SLA).

#### **1.1.Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

*Në lidhje me sa më lart grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje observacionin në lidhje me realizimin e rekomandimit 1.1, sqarojmë se për plotësimin e këtij rekomandimi duhet bashkëpunim i të dy institucioneve, pasi ASIG është marrësi i shërbimit dhe AKSHI është dhënësi i suportit.*

*Rekomandimi KLSH-së lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo çështje, pa anashkaluar punën e bërë deri në këtë kohë nga ana e ASIG, për pasojë rekomandimi i lënë nuk ndryshon.*

#### **2.Pretendimi i subjektit (mbi rekomandimet 2.1;3.1;4.1;5.1;6.1):**

-Siç është konstatuar në Projekt Raport, nga Grupi auditues, ASIG ka marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi, duke parashikuar realizimin e tij gjatë zbatimit të projektit TIK “Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar në ASIG”, ku autoritet kontraktor është AKSHI.

\*\*\*

-Siç është konstatuar dhe nga Grupi Auditues, në Projekt Raport, ASIG ka marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi duke j'u drejtuar zyrtarisht të gjithë Autoriteve Publike Përgjegjëse me qëllim dërgimin nga këta të fundit të informacionit gjeohapësinore dhe Metadatave, siç citohej në Gjetjet dhe Rekomandimet e Auditimit të mëparshëm...

\*\*\*

-Siç është konstatuar dhe nga Grupi Auditues, ASIG ka marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi duke ju drejtuar zyrtarisht Autoriteve Publike Përgjegjëse, për përditësimin dhe standartizimin e të dhënave gjeohapësinore ...

\*\*\*

... Përsa i takon plotësimin të pikave 2 dhe 3 është e nevojshme ndërhyrje në sistemin TIK të Gjeoportalit Kombëtar (moduli i databazës dhe administrimit). Kjo ndërhyrje është parashikuar që të zhvillohet gjatë kontratës për "Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar në ASIG", ku autoritet kontraktor është AKSHI, e cila është duke u zbatuar.

\*\*\*

-Përsa i takon plotësimin të këtij rekomandimi, ashtu siç është shprehur dhe në Aktin e verifikimit nga Grupi Auditues, është e nevojshme ndërhyrje në sistemin TIK të Gjeoportalit Kombëtar (moduli i katalogut të metadatave). Kjo ndërhyrje është parashikuar që të zhvillohet gjatë kontratës për "Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar në ASIG", ku autoritet kontraktor është AKSHI, e cila është duke u zbatuar.

#### **2.1.Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

*Në lidhje me këto rekomandime, ASIG ka parashtruar argumente që janë përgjithësisht shpjeguese dhe janë trajtuar edhe në akt verifikimin e mbajtur si dhe në projektraportin e auditimit. Observacionet nuk prekin dhe nuk hedhin poshtë rekomandimet e auditimit por në thelb i pranojnë ato dhe janë argumente të përshkruara nga grupi i auditimit në akt verifikimin e mbajtur, për pasojë rekomandimet nuk ndryshojnë.*

---

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**